

VENDIM
Nr.227, datë 19.4.2006

**PËR TRANSFERIMIN E TRUALLIT DHE TË OBJEKTIT “HIDROVORI I QYTETIT
VLORË”, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT, NË PRONËSI TË BASHKISË SË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme, publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e truallit dhe të objektit “Hidrovari i qytetit Vlorë”, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4631,2 m² nga e cila 171,2 m² ndërtesë, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në pronësi të bashkisë së Vlorës.

2. Bashkisë së Vlorës nuk i lejohet tjetërsimi ose ndërrimi i destinacionit të objektit “Hidrovari i qytetit Vlorë”.

3. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, kryetari i bashkisë së Vlorës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha